



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Date: 12.06.2026

Komuna e Kamenicës

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë



Bazuar në nenin 14 paragrafi 14.1, 14.2 dhe 14.3 si dhe nenit 17 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë në Komunën e Kamenicës, nxjerr këtë:

THIRRJE PUBLIKE

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË SHTANDEVE MOBILE PËR PLASIMIN E PRODHIMEVE VENDORE

Duke u bazuar në nevojat e prodhuesve vendor të Komunës së Kamenicës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë fton të gjithë prodhuesit vendor, si dhe iniciativat për prodhime të vogla, të cilët janë të interesuar për promovimin dhe plasimin e produkteve të tyre, të aplikojnë për shfrytëzimin e shtandeve mobile të vëna në dispozicion nga Komuna e Kamenicës.

Shtandet mobile janë krijuar për të mbështetur zhvillimin e veprimtarive prodhuese lokale dhe për të lehtësuar prezantimin e produkteve vendore para qytetarëve dhe konsumatorëve.

Ju njoftojmë se shtandet mobile mund të shfrytëzohen vetëm brenda territorit të Komunës së Kamenicës. Caktimi i lokacionit për vendosjen e tyre bëhet në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, në përputhje me rregulloret komunale në fuqi.

Ftojme të gjithë të interesuarit që të aplikojnë dhe të përfitojnë nga kjo mundësi për promovimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të tyre prodhuese. Për informata shtesë lidhur me procedurën e aplikimit, mund të drejtoheni në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.

Komuna do të jap në shfrytëzim gjithsej 7 (shtatë) shtande mobile në afat prej 6 (gjashtë) muaj.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Kërkesa për aplikim (merret te QSHQ, kati i I (parë) – objekti i Komunës);
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Certifikata e biznesit ose numri identifikues i fermerit – NIF;
4. Të përshkruhet veprimtaria e biznesit që ushtrohet nga aplikuesi dhe të cekën llojet e produkteve për plasim;
5. Dëshmi për pagesën e obligimeve komunale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Përparësi në përfitimin e shtandeve mobile do të kenë:

1. Gratë-mbajtëse të familjes;
2. Prodhuesit që janë apo kanë familjarë me nevoja të veçanta;
3. Prodhuesit që kanë produkte te vogla inovative.

Shqyrtimi i aplikacioneve do të bëhet nga komisioni i emëruar nga Kryetari i Komunës.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që vijnë pas afatit, nuk do të merren parasysh.

Lista e përfituesve do të publikohet në ueb-faqen zyrtare dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

Afati i aplikimit është nga data 12.06.2026 deri 23.06.2026.

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet te QSHQ, kati i I (parë) – objekti i Komunës.

